

**AKT THEMELIMI  
ISHOQËRISË TREGTARE  
"POWER ENERGY" sh.p.k.**

Sot, më datë 16/08/2023, ortaku themelues:

**Leonard KASTRATI**, i datëlindjes 19.11.1984, lindur në Krumë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr SA7252952 dhe nr personal I41119082D;

Ka vendosur të themelojë shoqërinë tregtare "POWER ENERGY" sh.p.k, me kushtet si më poshtë:

**NENI 1  
Statusi Juridik**

Shoqëria Tregtare "POWER ENERGY" sh.p.k. është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare", i ndryshuar (në vazhdim referuar si "Shoqëria"). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.  
Ajo ka formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 2  
Emri i shoqërisë**

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "**POWER ENERGY**" sh.p.k.

**NENI 3  
Objekti i veprimitarise**

Objekti i Veprimitarise së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në:

- Import Eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike.
- Financim, projektim, zhvillim, ndërtim i hidrocentraleve dhe impianteve të tjera për prodhimin e energjisë elektrike, shpërndarjes, transmetimit të energjisë elektrike, vënia në punë, administrimi, mësimdhënies, shfrytëzimi i tyre, prodhimi dhe tregëtimi i energjisë elektrike.
- Ndërtimi, projektimi, konsulencë, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit.
- Import eksport i të gjitha llojeve të materialeve dhe makinerive të ndërtimit dhe jo vetëm.
- Ndërtim, përmirësim, mësimdhënies, shfrytëzimi i rrugëve mbikalimeve dhe nënkalimeve, urave, tuneleve, portave, aeroporteve, digave dhe veprave të tjera të infrastrukturës.
- Shoqëria mund të kryejë cdo veprimi tjetër tregtare të lejueshme që është e nevojshme dhe e dobishme për të përbushur objektin e saj.



**NENI 4**  
**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Sheshi ITALIA, pasuria nr 7/83, zona kadastrale 8160, volumi 51 faqe 163, Tiranë.

**NENI 5**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i shoqerisë është në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë.

Ortaku i shoqërisë zotëron kuotat si më poshtë:

Leonard KASTRATI zotëron 1(një) kuotë të kapitalit themeltar të barabartë me 100% të tij në vlerën 1.000.000 lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total.

**NENI 6**  
**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Afat kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimitarës dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

**NENI 7**  
**Organet Drejtuese**

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqerisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i cili mund te zgjidhet për një afat deri ne pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë "POWER ENERGY" Sh.p.k. do të jete:

1. **Leonard KASTRATI**, i datëlindjes 19.11.1984, lindur në Krumë dhe banues në Tiranë, identifikuar nga pasaporta me nr. SA7252952 dhe me nr personal I41119082D, me adresë: Sheshi ITALIA, pasuria nr 7/83, zona kadastrale 8160, volumi 51 faqe 163, Tiranë.



Shoqëria do të përfaqësohet përpëra cdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjeter publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**NENI 8**  
**Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortaket Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 9**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

**NENI 10**  
**Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhen shqipe dhe nënshkruhet pa verejtje nga Ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES**

**Leonard KASTRATI**

